



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 05 Prill 2023

Nr: 267

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ Z. FLORENC DOKA PERSON PËRGJEGJËS NË BASHKINË
CËRRIK, PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË NDALUARA NGA KOMISIONI
QENDROR I ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023**

Sot më datë 05 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Cërrik

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj z. Andis Salla, kryetar i bashkisë Cërrik, për zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 04.04.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë kërkesën nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për ndalimin e 3 (tre) veprimtarive publike të raportuar për tu zhvilluar më datën 30.03.2023.

Data: 05 Prill 2023

Nr: 267
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës në Bashkinë Cërrik”

Në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 25.3.2023, Bashkia Cërrik ka raportuar veprimtaritë publike me objekt si më poshtë:

1. *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 13:00, me vend të zhvillimit në “Shales, NJA Shales”, me folës kryesorë: Damian Gjicknuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjicknuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.
2. *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 14:00, me vend të zhvillimit në “Shtepanjë”, me folës kryesorë: Damian Gjicknuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjicknuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.
3. *“Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”*, për t’u zhvilluar në datë 30.3.2023 ora 15:00, me vend të zhvillimit në “Shtermen”, me folës kryesorë: Damian Gjicknuri (Drejtues Politik Qarku), Andis Salla (Kryetari i Bashkisë), pjesëmarrësit: Damian Gjicknuri, Andis Salla, administratori njësisë, komunitet.

Me vendimin nr. 213, datë 28.3.2023, në përputhje me nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, është vendosur ndalim i zhvillimit të veprimtarive publike me datë 30 Mars 2023.

Shënimi “NDALUAR NGA KQZ”, është pasqyruar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 213, datë 28.03.2023, i është dërguar elektronikisht për njohje dhe zbatim, personit përgjegjës pranë bashkisë Cërrik.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 04.04.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, nga KRIIK ka marrë denoncimet **e regjistruara me nr. 247, 248, 249 ID**, për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara nga bashkia Cërrik edhe pse ishin ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 213, datë 28.03.2023., të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 3 (tre) denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre denoncimeve.

Në këto denocime pretendohet si vijon:

Data: 05 Prill 2023

Nr: 267
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës në Bashkinë Cërrik”

- Denoncimi **247 ID**, “Konstatohet se aktiviteti është zhvilluar me pjesëmarrjen e gjithë personave për të cilët ishte bërë njoftimi. Nga kontrolli i bërë në faqen zyrtare të Facebook të kryetarit të bashkisë Cërrik, dhe bashkisë Cërrik nuk figuron ndonjë postim që lidhet me këtë veprimtari.

Ndërkohë që në profilin e kryetarit të bashkisë Cërrik z. Andis Salla (profil i hapur, linku: <https://ëëë.facebook.com/andi.salla>) është ri-shpërndarë postimi i bërë nga z. Damian Gjikhuri (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes).

“Cërrik Takim me banorët e lagjes së "Trokallinjve" në fshatin Shalës.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”

- Denoncimi **248 ID**, “Konstatohet se aktiviteti është zhvilluar me pjesëmarrjen e gjithë personave për të cilët ishte bërë njoftimi. Nga kontrolli i bërë në faqen zyrtare të Facebook të kryetarit të bashkisë Cërrik, dhe bashkisë Cërrik nuk figuron ndonjë postim që lidhet me këtë veprimtari. Ndërkohë që në profilin e kryetarit të bashkisë Cërrik z. Andis Salla (profil i hapur, linku: <https://ëëë.facebook.com/andi.salla>) është ri-shpërndarë postimi i bërë nga z. Damian Gjikhuri (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes).

“Cërrik Takim me banorët e fshatit Shtëpanjë në Njësinë Administrative Gostimë.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim

- Denoncimi **249 ID**, “Konstatohet se aktiviteti është zhvilluar me pjesëmarrjen e gjithë personave për të cilët ishte bërë njoftimi. Nga kontrolli i bërë në faqen zyrtare të Facebook të kryetarit të bashkisë Cërrik, dhe bashkisë Cërrik nuk figuron ndonjë postim që lidhet me këtë veprimtari. Ndërkohë që në profilin e kryetarit të bashkisë Cërrik z. Andis Salla (profil i hapur, linku: <https://ëëë.facebook.com/andi.salla>) është ri-shpërndarë postimi i bërë nga z. Damian Gjikhuri (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes).

“Me Njerëzit për Njerëzit. Me Andisin në Njësinë Administrative Gostimë në takimin me banorët e fshatit Shtërmen. Diskutuar mbi zhvillimin që ka marrë kjo zonë si pasojë e vëmendjes së treguar nga bashkia si edhe problematikat për të cilat po punojmë dita-ditës për ti dhënë zgjidhje.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Cërrik ka zhvilluar aktivitetet e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Cërrik, përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë, ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës në bashkinë Cërrik, në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 05 Prill 2023

Nr: 267
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Florenc Doka, person përgjegjës në Bashkinë Cërrik"